



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË**

Faza e tretë

Viti shkollor 2022-2023

01 prill 2023

ZGJIDHJET

Pyetja 1

a) **2 pikë**

Figura 1 – dhjetor

Figura 2 – qershor

b) **2 pikë**

Sipërfaqja e Tokës merr më shumë nxehtësi në figurën 2, pasi:

- Këndi i rënies së rrezeve diellore në figurën 2 është më i madh, ndërsa te figura 1 është më i vogël.
- Te figura 2 rrezet diellore shpërndahen në një sipërfaqe më të vogël, ndërsa në figurën 1 në një sipërfaqe më të madhe. Për pasojë, energjia shpërndahet në një sipërfaqe më të madhe dhe thithet më pak energji për njësi të sipërfaqes.

c) **2 pikë**

Temperatura e ajrit në tokë është më e madhe në orën 14:00, pasi temperatura e ajrit ngrohet më shumë nga rrezatimi tokësor sesa ai diellor. Toka deri në orën 12:00 thith nxehtësi dhe pas orës 12:00 fillon ta lëshojë, duke bërë që të rriten temperaturat e ajrit.

Pyetja 2

a) **3 pikë**

Raporti midis lagështirës absolute dhe lagështirës që duhet të përmbajë një metër kub ajër për t'u ngopur në një temperaturë të caktuar quhet lagëshirë relative

Lagështira relative shprehet me përqindje. Pesha e përqindjes së saj do të thotë që ajri përmban një sasi të caktuar të avullit të ujit në një temperaturë të caktuar. Në pikën e ngopjes lagështira relative është 100%, ndërsa, kur është e pranishme gjysma e sasisë së mundshme lagështira relative është 50%.

b) **1 pikë**

Me rritjen e gjerësisë gjeografike, për shkak të uljes së temperaturës, ndodh një rritje e lagështirës relative, duke arritur vlera maksimale në zonat polare.

c) **3 pikë**

$$\text{Lag relative} = \frac{\text{lag ab}}{\text{lag ngop}} \cdot 100\%$$

$$\text{Lag relative} = \frac{30 \text{ gr}}{50 \text{ gr}} \cdot 100\%$$

$$\text{Lag relative} = 60\%$$

d) **3 pikë**

$$\frac{x \text{ gr}}{15 \text{ gr}} = \frac{80\%}{100\%}$$

$$\frac{15 \text{ gr} \cdot 80\%}{100\%} = 12 \text{ gr}$$

Pyetja 3

a) **6 pikë**

Temperatura

Kur ajri është më i ngrohtë, trysnia atmosferike është më e vogël në krahasim me rastin kur ajri është më i ftohtë. Kjo ndodh pasi ajri i ngrohtë është më pak i dendur dhe si rrjedhim është më i lehtë, synon të ngjitet lart duke ushtruar trysni atmosferike më të vogël.

Lagështia e ajrit

Kur ajri ka lagështi më të madhe, pra kur ai përmban një sasi më të madhe të avujsh uji, ai ushtron një trysni më të vogël në krahasim me ajrin që është më i thatë. Kjo ndodh sepse molekulat e ujit janë më të lehta se molekulat e gazeve të tjera të ajrit (një litër avuj uji peshon afërsisht sa gjysma e nje litri oksigjen dhe sa dy të tretat e një litri azot) Pra për vëllime të njëjta, ajri i lagësht është më i lehtë se sa ai i thatë që përmban më shumë oksigjen dhe azot. Duke qenë më i lehtë ushtron trysni më të vogël.

b) **4 pikë**

Në rastin kur ajri është i ngrohtë dhe njëkohësisht i lagësht si në gjerësitë ekuatoriale, bashkimi i këtyre dy faktorëve pra temperaturë dhe lagështi e lartë çon në zvogëlimin e trysnisë duke krijuar zonës e trysnisë së ulët në rajonet ekuatoriale)

Në rastin kur ajri është i ftohtë dhe i thatë si në gjerësitë polare, bashkimi i këtyre dy faktorëve pra temperaturë e ulët dhe lagështirë e ulët çon në rritjen e trysnisë atmosferike duke krijuar zonën e trysnisë së lartë në rajonet polare.

Pyetja 4**5 pikë**

Klasifikimi: faza 4

Popullsia është stabilizuar dhe po përjeton një shtim të ulët natyror.

Niveli i vdekjeve është shumë i ulët si pasojë e kujdesit shëndetësor dhe ushqimit.

Niveli i lindjeve është ulur si pasojë e ndryshimeve kulturore, kontrollit të lindjeve, planifikimit familjar.

Pyetja 5**a) 2 pikë**

Lëvizjet izostazike ndodhin atëherë kur:

- Territori është rënduar ose liruar nga akullnajat. Nga ekzistenca e akullnajave ndodh ulje e territorit, ndërsa me shkrirjen e akujve, territori lehtësohet, duke sjellë ngritjen e tij.
- ndodh erozion, i cili shoqërohet me ngritje të territorit, ndërsa aty ku depozitohen materialet e erodura ndodh ulje e territorit.

b) 2 pikë

Erozioni i maleve herciniane të Tian Shanit ka sjellë lirim të tyre nga ngarkesa dhe ngritjen e tyre në lartësi mbi 6000 m. Akumulimi i depozitimeve në oqeanet dhe detet, në periferitë e kontinenteve sjell uljen në përgjithësi të ngadalshme të tyre.

Pyetja 6 **10 pikë**

Relievi i fundit të oqeanit përgjithësisht është i rregullt. Në të dallohen: *kreshtat mesoqeanike, gropat e thella oqeanike, fushat abisale, platforma kontinentale dhe shpatet nënujore kontinentale.*

- Gropat e thella oqeanike (humnerat) të cilat përgjithësisht gjenden në pjesët më anësore të oqeanëve. Gropat oqeanike shkojnë deri në 6000 metra thellësi dhe me largësi 100-200 km larg nga kontinentet. Gropa më e thellë oqeanike është ajo e Marianeve në Oqeanin Paqësor rreth 11000 m thellësi.
- Fushat abisale me thellësi 3000-6000 m të rrafshëta dhe të mbuluara nga grumbullimet të imta duke zënë mbi gjysmën e fundit detar.
- Kreshtat mesoqeanike gjenden në pjesën qendrore me gjatësi mijëra km dhe lartësi mbi 3000-4000m. Kur kreshta del mbi ujë formojnë ishuj si kreshta mesoqeanike e Atlantikut. Nga pjesa qendrore e tyre shpesh del llavë duke zgjeruar fundit e oqeanit.
- Platformat kontinentale janë pjesë nënujore të kontinenteve me thellësi deri në 130 m dhe që mund të shtrihen në brendësi të detit deri në 1500km, por dhe mund të mungojnë.
- Shpatet kontinentale gjenden në kufirin midis pjesën nënujore të kontinenteve dhe oqeanëve. Ato mund të jenë thyerje të mëdha kontinentale gjatë krijimit të gropave oqeanike. Shpatet janë të pjerrëta dhe shtrihen deri në thellësinë 2000m.

Pyetja 7 **5 pikë**

